

## Qfarë mjekimi

Ligji Pritja përshkruan të drejtën në mjekim për kërkuesit e azilit. Ata kanë të drejtë në shoqërim mjekësor për të patur një jetë konform dinjitetit human. I përket mjekut të përcaktoj nëse nevojat mjekësore të kërkuesit për azil i përgjigjen këtij kuptimi. Një tjetër kusht specifikon që mjekimet duhen të përfshihen në nomenklaturën e INAMI-t. Disa përjashtime janë të cekura në Dekretin Mbretëror të 9 prillit 2007.

Kujdes : mbi bazën e Ligjit Pritja, Fedasil-i parasheh të drejtën në të njëjtat mjekime për gjithë azilkërkuesit. Sidoqoftë , CPAS-at i paguan SPPIS-i sipas tjera kritere, dhe është e mundur që një CPAS të intervenoj në fondet e veta për disa mjekime për të cilat azilkërkuesi ka drejtë.

## Apel ?

Nëse azilkërkuesi nuk pajtohet me një vendim të marrë për qasjen e tij në mjekimet, ai mund të bëjë apel . Procedura ndryshon nëse personi i është drejtuar CPAS-it ose Fedasil-it ( ose njërit prej partnerëve të tyre ). Kundër një vendimi të CPAS-it ( ose kundër një vendimi të pa marrë ), apeli mund të bëhet brenda 3 muaj te Gjykata e Punës. Kundër një vendimi të Fedasil-it ( ose të njërit prej partnerëve të tij ), një dorëshkrim I shoqëruar me mendimin e mjekut, duhet dërguar drejtorit gjeneral të Fedasil-it, i cili ka afat një muor për tu deklaruar. Në rast të një vendimi negativ ( ose në mungesë të vendimit ), apeli mund të bëhet brenda 3 muaj në Gjykatën e Punës.

## Disa kontakte të nevojshme

### Shërbimi Dispatching Fedasil

Për një pranim ose informata mbi kodin 207 WTC II Chaussée d'Anvers 59B (salla e pritjes në katin përdhësë, djathtas në hyrje )  
1000 Bruxelles, 02/793.82.40

### Fedasil, Celula e shpenzimeve mjekësore

[medic@fedasil.be](mailto:medic@fedasil.be); ( fax ) : 02/213.44.12  
( tel ) : 02/213.43.25 (FR) ose 02/213.43.00 (NL)

Fletushkat këtu poshtë janë në dispozicion në frengjishtë, hollandisht, anglisht, spanjollisht, rusisht, portugalisht, mandarin,.....Mund ti shkarkoni në sitin tonë në internet.

- Ndhmë mjekësore urgjente personave pa qëndrim legal.
- Statëzania, lindja dhe mjekimet pas lindjes për femrat pa qëndrim legal.
- Sigurim shëndetësor për personat pa leje qëndrimi ose I pabazuar.
- Qëndrim ( I shkurt ) për arsye mjekësore.
- Mjekime të shëndetit mendor për personat pa leje qëndrimi.
- Viza për arsye mjekësore dhe mbështetja.
- Çka duhet bërë në rast aksident pune e nëse nuk keni pasë kontrat.
- Mbështetje mjekësore në rast kthimi vullnetarisht.
- Qasje në mjekime për qytetarët european.
- Medimmigrant – Prezantim

## Shëndetësi dhe azil



  
**Medimmigrant**

### Informata me email dhe me telefon

Telefonatë permanente :  
Hëne : 10 - 13h  
Marte : 14 - 18h  
Premte : 10 - 13h  
Tél. 02/274 14 33/34 • Fax 02/274 14 48  
E-mail: [info@medimmigrant.be](mailto:info@medimmigrant.be)  
[www.medimmigrant.be](http://www.medimmigrant.be)  
**( ! nuk ka vizita në vend )**  
Adresa postale :  
164, rue Gaucheret • 1030 Bruxelles  
Fortis: 001-2389649-33



Met de steun van de  
Vlaamse Gemeenschapscommissie  
en de Gemeenschappelijke Gemeenschapscommissie



V.U.: vzw Medimmigrant,  
Gaucheretstraat 164, 1030 Brussel

Azilkërkuesit në Belgjikë kanë drejt në shoqërim mjekësor gjatë procedurës së kërkesës për azil. Varësisht prej largësisë ose situatës administrative, përfitim i këtij shoqërimi mund të ndryshoj. Nëse azilkërkuesi nuk din te cili shërbim duhet drejtuar, kodi 207 të Regjistrimit të Pritjes ( nëse ky kod është aktiv )<sup>1</sup> mund ta informoj. Ky kod tregon në parim « vendin e detyrueshëm të regjistrimit » i caktuar për azilkërkuesin

## Qasje në mjekim

### Azilkërkuesi qëndron në një qendër të përbashkët të pritjes ( kodi 207 = qendra e pritjes )

Azilkërkuesin mund ta kontrolloj mjeku I qendrës. Ky mjek mund ta drejtoj nga tjerë mjek ose shërbime mjekësore. Azilkërkuesi mund të vendos të zgjedh mjekun mirëpo shpenzimet I bart vetë.

### Azilkërkuesi qëndron në një nismë të pritjes individuale ( code 207 = nisma e pritjes )

Këto janë vende të pritjes që drejtohen nga një CPAS ( = nisma lokale e pritjes ) ose nga Vluchtenlingenwerk Vlaanderen ose nga CIRE (ose partnerët e tij ). Secili partner e ka mënyrën e vetë të organizimit të pritjes.

Disa punojnë me mjekë të kontraktuar, disa tjerë i lënë vendim të lire marrësit të mjekimit; disa punojnë me karta mjekësore e disa jo.

### Azilkërkuesi nuk qëndron në një structure të pritjes dhe ka kodin 207 “no show” (ose kodi SPW)

Celula e Fedasil-it për shpenzime mjekësore (shih më larg ) është përgjegjëse për pagesën e shpenzimeve mjekësore për kategoritë e azilkërkuesëve që vijojnë:

- Azilkërkuesit që nuk kanë pranuar ofertën për vendin e pritjes në shërbimin Dispatching të Fedasili-t. Nuk dëshirojnë të qëndrojnë në një qendër që para kanë braktis vullnetarisht vendin e pritjes.

<sup>1</sup> .Vërejtje: është e mundur të shihet një kod 207 edhe pse jo aktiv (psh. Kërkesë e hedhur poshtë)

- Azilkërkuesëve të cilëve Fedasil-i nuk ju ka dhënë vend të pritjes ( kërkesë e dytë për azil ose shumë kërkesa ).
- Azilkërkuesëve të cilëve u është caktuar një vend pritje në ndonjë hotel ose qendër të urgjencës ( këto struktura nuk njihen si struktura klasike të pritjes ).

#### Funkcionimi I Celulës për shpenzime mjekësore

Personi, marrësi I mjekimeve ose I treti duhet bërë marrëveshje me shkrim për mjekimet e ardhshme ( =pretence ). Nëse kjo nuk është e mundur, marrësi I mjekimeve mund të dërgoj faturën në Celulën e shpenzimeve mjekësore, mirëpo një vërtetim të “mjekimeve urgjente” është nevojshme.

### Azilkërkuesi nuk ka ( ose nuk ka më ) kod 207

Në fakt, për arsye të rrethanave të jashtëzakonshme, ndodh që disa azilkërkuesëve nuk ju ipet kodi 207 ose ju është hjekur. Në parim, këta azilkërkues kanë drejtë në ndihmën sociale të CPAS-it të vendit ku ata qëndrojnë (përfshirë edhe shoqërim mjekësor).

### Një vend kthim i është dhënë azilkërkuesit (kodi 207= vendi kthim)

Nëse azilkërkuesi merr një vendim që s’është marr parasysh nga CGRA, ose merr një vendim negativ nga Këshilli I procesit gjyqësor për të huaj (CCE), mund ti ipet një vend kthimi në një qendër të pritjes të Fedasil-it, ku pritja dhe shoqërimi mjekësor ofrohen. Nëse azilkërkuesi nuk shkon në qendrën për kthim që I është caktuar, ose del prej aty, kodi 207 ndryshon “normalisht “në kodin “no-show”. Gjithësesi, Celula për shpenzime mjekësore ( shih më lart) është përgjegjëse gjatë periudhës të mbuluar nga Urdhëri për të lëshuar vendin (OQT). Vërejtje: Nganjëherë dhe në disa kushte, disa azilkërkues me vendim negativ, mund të qëndrojnë në vendin e parë të pritjes (psh. banues me problem shëndetësor dhe familjarët e tij, mbi prova të dhëna) <sup>2</sup>.

<sup>2</sup> Udhëzime Fedasil të 23/09/2013 që kanë të bëjnë me rrugën e kthimit.

### Azilkërkuesi gjendet në qendër të mbyllur/burg

Azilkërkuesi varet prej mjekimeve të disponueshme në qendër të mbyllur/burg ose nga shërbimet mjekësore në të cilat orientohet.

Mjekimet I bart respektivisht SPF Intérieur/Justice, e jo Fedasil-I ose SPP Inégration Sociale.

Azilkërkuesi mund të kërkon të mjekohet nga një mjek që e zgjedh vetë, por shpenzimet i bart vetë.

## Fundi i drejtave për mjekime

Njëherë që OQT-ja dhe afati i apelit kanë skaduar, Fedasil-i nuk ka më kompetenca (vetëm nëse azilkërkuesi përfiton një zgjatje të pritjes).<sup>3</sup>

Nëse azilkërkuesi nuk ka më leje qëndrimi legal, ai mund të apeloj në procedurën Ndihmë Mjekësore Urgjente nëpërmjet CPAS-it të vendit ku banon (shih fletushkën AMU).

Nëse azilkërkuesi (ose familjarët e tij) merr leje qëndrimi mbi 3 muaj, atëherë ai duhet lëshuar strukturën e pritjes dhe të mbroj tjerat drejta që i ka. Në rast se 9ter pranohet, azilkërkuesi mund t’i kërkoj Fedasil-it leje për të lëshuar pritjen.

## Disa vërejtje

- Aneksi 26quater : nëse OE-ja nuk merr në konsideratë kërkesën për azil, për arsye të procedurës Dublin, procedura e azilit nuk « fillon » në Belgjikë , mirëpo në parim, personi ka drejt në ndihmë materiale derisa të transferohet në Shtetin evropian kompetent.<sup>4</sup>
- Pranim në sigurim shëndetësor-invaliditet (AMI): Kërkuesit për azil, të cilët pas 6muaj të procedurës ,nuk kanë marrë asnjë vendim prej CGRA, mund të kërkojnë një leje pune C, e nëse punojnë të regjistrohen në AMI si mbajtës të lejes. Disa kërkues për azil mund të regjistrohen në AMI me tjera kushte, si për shembull nëse janë me aftësi të kufizuara, ose janë në mbikqyrje të tjetërkujt, nëse mbi të gjitha tjera kushte janë të plotësuar

<sup>3</sup> Udhëzime Fedasil 15/10/2013 që kanë të bëjnë me ndihmën material.

<sup>4</sup> Vendim I Gjyqit të Drejtësisë me 27/09/2012